

Grimca Krishtlindje (pjesa 1 nga 5)

Grimca Shprese

Mirë se na u bashkove në festimin e kishës sonë. Sot fillojmë serinë “Grimca Krishtlindje”. Uroj që kjo seri të sjellë grimca shprese, dashurie, paqeje dhe gëzimi në jetën dhe familjen tënde.

Kujtimi më i bukur në kohën e Krishtlindjes për mua ndër vite është kur do festonim Krishtlindjen për herë të parë. Së pari, duhet të bindnim babin pse po e vinim dëllenjën, pemën e dëllenjës; atë kishim si pemë Krishtlindjeje në fshat. Pse duhet ta vinim Pemën e Vitit të Ri kaq herët? Sepse ajo ishte pema e Vitit të Ri, jo e Krishtlindjes. Akoma ka njerëz të brezit të prindërve të mi që mendojnë se është pema e Vitit të Ri.

Po kërkoja në internet për Pemën e Krishtlindjes dhe gjeta se në shek. 16 u përdor për herë të parë nga të krishterët e Gjermanisë dhe besohet se Martin Luteri ishte i pari që i vuri ndriçim pemës së Krishtlindjes, dhe ishin qirinj të ndezur. Dhe kur drita u zbulua nga 2 shekuj më vonë nga Thomas Edison, shoku i tij ishte i pari që i vuri drita pemës së Krishtlindjes! Dhe i pari që vuri një pemë të madhe në mes të qytetit. Kështu që është pemë për të festuar Krishtlindjen, jo Vitin e Ri.

Dua të lexoj kujtime të bukura Krishtlindjeje që keni dërguar ju:

“Gjëja më e rëndësishme për mua ishin dhuratat e Krishtlindjes. Disa shoqe të mamit të huaja ndanin ungjillin me ne në formë dhuratash gjatë Krishtlindjes dhe për mua dhe vëllain ishte koha kur vinin 'pakot' nga jashtë. Çuditërisht mami arrinte t'i fshihte mirë e t'i linte poshtë pemës në datën 24. Kjo e bëri për mua Krishtlindjen një festë të veçantë edhe para se të besoja te Krishti.”

“Kur lindi vajzën e vogël, ajo dhe unë ishim të sëmura por erdhi dita dhe unë dola nga spitali ndërsa vajza ishte në inkubator. Një ditë e pyeta doktoreshën se kur do të dalë vajza nga inkubatori, më thanë mbas vitit të ri; vajza lindi më datën 12 dhjetor. Më datën 24 dhjetor në darkë, unë bashkë me tre fëmijët u lutëm në emrin e Jezusit që vajza e vogël të dalë nga spitali që të festonim gjithë familja bashkë. Dhe të nesërmen, më 25 dhjetor, vajza u bë mirë dhe doktoresha më la ta merrja në shtëpi.”

“Krishtlindja më e veçantë për mua ishte viti që shkoi, kur në festimin e Krishtlindjes erdhi edhe mami. Ishte hera e parë që mami më “ndiqte” në

Kishë. Isha lutur shumë që të pranonte të vinte. Ajo erdhi, u njoh me shumë pjesëtarë të kishës, u kënaq shumë dhe u prek nga mesazhi. Sytë e saj të përbotur ishin fotografia më e bukur e Krishtlindjes për mua.”

“Ndërsa për mua ka qenë data 25 dhjetor. Dita kur Krishti hyri në zemrën time. E ndërsa shihja vajzën dhe djalin të lumturuar, dhe unë isha me lot gëzimi e tëra. U afrova pranë tyre dhe u thashë: Edhe unë u bëra bijë e Jezusit.”

“Më 24 dhjetor të vitit të kaluar jam lutur Zotit të më sillte në jetë një djalë sepse kisha dy vajza dhe Perëndia i dëgjoi lutjet e mia. Lavdi Perëndisë. Emrin djalit ia kam vënë Noel, që do të thotë Krishtlindje.”

Sa gëzim ka sjellë kudo në botë Lindja e Jezusit. Që nga ajo ditë, vit pas viti, shpresë, gëzim, dashuri, paqe sjell Ai në jetët tona.

“Prej shumë vitesh e pres me shumë gëzim këtë festë të madhe, por jo gjithmonë kam pasur mundësi ta festoj në kishë. Vitin e kaluar kam marrë super dhurata nga Perëndia: Vajza ime ishte në Krishtlindjen e parë në adhurim, familja ime për herë të parë bashkë në kishë, dhe familja e motrës gjithashtu erdhi nga Vlora për të festuar me ne. Ç’ të shtoj më!? Zoti të jep shumë më shumë se sa ne kërkojmë. Faleminderit Perëndisë për super bekimet e Tij.”

Faleminderit për këto Grimca të bukura Krishtlindjeje që ndatë me ne.

Sot do të shikojmë bashkë: **Grimca Shprese.**

Uroj shumë që ky mesazh të sjellë grimca shprese në jetën tënde. Do e filloj me një pyetje: Për çfarë po shpreson ti këto kohë?

Gruaja ime shpreson që do i bëj dhuratë lavastovilje për Krishtlindje. Është viti i dytë që shpreson dhe nuk heq dorë. Kemi kursyer ca lekë dhe uroj që do të plotësohet këtë vit.

Ti ke shpresa, njerëzit rreth e qark teje kanë shpresa.

Ne jetojmë me shpresa çdo ditë! *Shpresa vdes e fundit*, thotë fjala e urtë shqiptare. Perëndia e di që kemi nevojë për Të, që me shpresë të çohemi që në mëngjes dhe të ëndërrojmë, shpresojmë, të ecim para.

Shpresën mund ta ndash në dy kategori, ose ka dy shije të ndryshme:

Të Shpresosh në Diçka Dhe të Shpresosh te Dikush

Të shpresosh në diçka

Për fëmijët këtë Krishtlindje mund të jetë: 'Shpresoj që do marr filan dhuratë.' Për të rinjtë, 'Shpresoj që do të blej filan rroba, telefon, videogame.'

Kur pyes çunat e mi në këtë moshë, çfarë duan për festë, më thonë 'Më jep lekë, se do blej vetë diçka.' Nuk kanë më besim te shijet e babit për rrobat.

Për studentët, shpresat mund të kenë lidhje me shkollën, me të dashurin/ën; për beqarët, 'Shpresoj t'ia bëjë bam ai djali/vajza sepse më duket ia ka ngrënë macja gjuhën, nuk po flet më, nuk po më fton më për kafe.' Për familjarët, shpresat janë për më të mirën e familjes.

Çfarë gjërash po shpreson ti këtë muaj?

'Shpresoj të filloj punë, shpresoj të blej shtëpi.'

Dikush mund të thotë, 'Shpresoj të fejojhem me dikë që ka dhe punë të mirë edhe shtëpi të mirë.'

Të gjithë shpresojmë për diçka. Disa shpresojmë për gjëra më serioze. "Shpresoj që kjo situatë të kalojë sa më lehtë, shpresoj që nëna, motra, të shpëtojnë nga lufta që po bën për jetën, nga sëmundja e keqe."

Nëse shpresa jote është e lidhur me diçka, me një gjë, me shëndetin, me çfarëdo gjëje, një ditë do të zhgënjehesh, sepse jeta ka ulje e ngritje. Jo çdo gjë që shpresojmë del ashtu siç e shpresojmë ne.

Kështu që pyetja e vërtetë mbetet:

Cila është shpresa jote themelore?

Ajo që të duhet ditë pas dite. Cila është ajo lloj shprese, ku ti shkon, ku ti mbështetesh, kur s'të dalin si duhet këto të tjerat, shpresat te gjërat, rrethanat? Ku shkon?

Vijmë te shija e dytë e Shpresës:

Të shpresosh në dikë

Dhe Ai dikush ku mund të shpresosh dhe të mos zhgënjehesh është Perëndia. Ja të shikojmë një super varg për këtë.

Romakëve 15:13 *'Dhe Perëndia i shpresës le t'ju mbushë me çfarëdo gëzimi*

dhe paqe me anë të besimit, që të keni mbushulli në shpresë, me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë!

Perëndia ynë është Perëndia i shpresës, që ka vendosur këtë dëshirë për të shpresuar në ne, e ka instaluar brenda nesh këtë lloj dëshire. Por është Ai që e përmbush, e plotëson, na mbush me të.

Shpresa është thelbësore për jetën. Pa të, s'bëjmë.

Po të shikosh dhe dëgjosh përreth, kemi parë njerëz që kanë humbur punën, shtëpinë, martesën, paratë, shëndetin, fëmijët, reputacionin, shoqëritë dhe lloj-lloj historish të dhimbshme. Dhe **kanë mbijetuar**.

Ka njerëz që kanë kaluar persekutime të frikshme si ato të kohës së Hitlerit, në kampet e përqendrimit dhe **kanë mbijetuar** ndaj vështirësive dhe fatkeqësive.

Por njeriu nuk mbijeton dot pa shpresë. Kur humb shpresën, ikën dëshira për të jetuar, fiket gëzimi në jetë. Perëndia që e di se sa na duhet shpresa, është Ai që na mbush me shpresë, na jep shpresë. Ja si thuhet te...

Fjalët e urta 13:12 *'Pritja e zgjatur e ligështon zemrën, por dëshira e plotësuar është një dru i jetës.'*

Pritja, shpresa e largët, shpresa e vonuar ta ligështon zemrën. Por dëshira e plotësuar është gëzim.

A duket sikur të gjithë po presim diçka në këtë kohë? Dhe ajo pritja mund të jetë ndryshe për këdo, ndoshta ke ditë që pret, javë, muaj, vite. Po pret që martesa jote të përmirësohet, po pret që ta mundësh atë vesin, zakonin që të lodh, po pret që fëmijët e tu të kthehen në rrugën e duhur, po pret për punën e duhur, po pret ditën që do të paguash kredinë dhe do të jesh pa borxhe. Po pret për atë lutjen që do të marrë përgjigje.

Perëndia i tha Abrahamit: 'Ti do të bëhesh baba i një kombi të madh.' Dhe premtimi iu dha kur ishte 75 vjeç dhe nuk kishte fëmijë. Ai priti 25 vite, kur u bë 100 vjeç dhe gruaja e tij 90 vjeçe ngeli shtatzënë dhe lindi një djalë, Isakun. Perëndia i tha Moisiut: 'Ti do të drejtosh popullin e Izraelit, të dalë nga skllavëria e Egjiptit dhe të shkojë drejt tokës së premtuar.' Dhe kjo ndodhi pas 40 vitesh pritje.

Esenca e gjithë Dhjatës së Vjetër është, SHPRESA. Ata prisnin dhe shpresonin që do të vinte Mesia, brez pas brezi. Perëndia iu jepte premtime dhe ata prisnin ardhjen e Tij. Që nga Zanafilla kap. 3 dhe kudo nëpër librat e

Dhjatës së Vjetër e gjen premtimin e ardhjes së Jezusit në tokë, Shpëtimtarit. 'Mos humbni shpresë, Ai do të vijë, Ai po vjen. Perëndia me ne, Perëndia në mish.' Ja dy premtime të libri i Isaia që u shkrua 700 vjet para se të vinte Jezusi:

Isaia 7:14 *'Prandaj vet Zoti do t'ju japë një shenjë: Ja, e virgjëra do të mbetet me barrë dhe do të lindë një fëmijë të cilin do ta quajë Emanuel.'*

Që do të thotë, Perëndia me ne. 700 vjet para Krishtlindjes së parë. Ja si thuhet te

Isaia 9:6 *'Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë. Mbi supet e tij do të mbështetet perandoria dhe do të quhet Këshilltar i admirueshëm, Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm, Princ i paqes.'*

Konteksti i kap. 9 është: mos e humbni shpresën, drita do të vijë, errësira do të ikë, vazhdoni të shpresoni.

Pastaj kur erdhi Jezusi, ja si thuhet.

Po para kësaj, dua të ndaloj këtu ku ndahet Dhjata e Vjetër me të Renë. Kam një Bibël në dorë, këtu në Bibël një fletë është, por në realitet janë 400 vite qetësi, 400 vite heshtje, nga profecia e fundit deri te ardhja e Jezusit.

Njerëzit i thirrën Perëndisë dhe për 400 vjet, asnjë zë profetik, asnjë fjalë nga Perëndia. Aq sa fetarët e asaj kohe mendonin që Perëndia është shkëputur nga njerëzimi, nuk komunikon më me njeriun. Por heshtja u thye. Ja ta lexojmë te:

Gjoni 1:1-3 *'Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. Ai (fjala) ishte në fillim me Perëndinë. Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij (fjala), dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë.'*

Fjala nënkupton Jezusin. Jezusi është Fjala, Perëndia nuk ka heshtur asnjë sekond. Jezusi ishte aty kur u krijua bota, dhe Ai e mban botën.

Gjoni 1:4-5 *'Në atë ishte jeta, dhe jeta ishte drita e njerëzve. Dhe drita shkëlqen në errësirë dhe errësira nuk e kuptoi.'*

Sa fjalë të bukura. Ai po citon profecitë të Isaia kap. 9, drita ka lindur, drita që prisnin shkëlqeu. Jezusi vjen si dritë, për ta mundur errësirën. Shpresa ka ardhur.

Gjoni 1:14 *'Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne; dhe ne soditëm lavdinë*

e tij, si lavdia e të vetëmlindurit prej Atit, plot hir e të vërtetë.'

Jezusi ishte Perëndia në mish, me trup njerëzor. Ai banoi mes njerëzimit. Jezusi e ndërroi adresën e shtëpisë, nga qielli e bëri tokë. Shpresa e ndërroi adresën, erdhi të banojë mes nesh. Dhe toka nuk mbeti më e njëjtë pas ardhjes së Tij. Jezusi erdhi, banoi mes nesh. Shpresa erdhi mes nesh, dhe bota nuk ishte më e njëllotë. Prandaj festojmë Krishtlindjen.

Ilustrim: Një histori e lezetshme me një fëmijë 4 vjeçar, që nuk flinte në dhomë vetëm se kishte frikë nga errësira, rafti është plot me lugatë, 'mos ik mami.' E ëma e vuri në gjumë, u lut me të dhe i tha: 'Perëndia është këtu me ty.' I vogli tha: 'E di, por unë kam nevojë për dikë me trup që ta shoh.'

Edhe ne kishim nevojë për një Perëndi me trup, me mish si njeri. Këtë bëri Perëndia për Krishtlindje. Dhe Ai do që të vendosim shpresën tek Ai. Dhe Ai është shpresë ku mund të mbështetemi. Kur gjërat e tjera të kanë zhgënjyer ose do të zhgënjëjnë, vendose shpresën te Perëndia që nuk të zhgënjën.

Shpresa e vërtetë është ajo që bazohet te Jezusi dhe premtimet e Perëndisë.

Shpresa jonë është e ndërtuar në atë se kush është Jezusi dhe se çfarë ka bërë Ai për ne. Ka pastruar të shkuarën, i ka dhënë qëllim të sotmes, na jep siguri për të ardhmen. Shpresa që vjen nga Jezusi, na bën të rezistojmë, të këmbëngulim, të mos heqim dorë. Nëse ti po drejton diçka, çfarëdo që po drejton, familje, skuadër, grup, shërbesë, punë, shpresa është ajo që të duhet dhe nga ty si lider pritet që të japësh shpresë. Nëse je anëtar i kishës, je lider me zemër si e Jezusit. Je lider që jep shpresë. Sidomos në kohë të tilla, lider i nevojshëm është ai/ajo që jep shpresë.

Që i bie, kur të tjerët shikojnë probleme, ti shikon mundësi, kur të tjerët janë të rënë, ti i jep kurajë vetes dhe të tjerëve. Kur të tjerët shikojnë dështim, ti shikon mundësi të re. Ka njerëz përreth që shikojnë të zeza në çdo gjë, të keqe në çdo gjë. Ti je ndryshe, ti je lider që shikon të bukurën, shikon mundësi, pozitiven. Ti shikon se si Perëndia nxjerr të bukurën nga hiçi, zero. Po si mund të ndodhë kjo? Sepse ja si thuhet te...

Kolosianëve 1:27 '*... që është Krishti në ju, shpresë lavdie,*'

Krishti në ju, brenda teje, kur Ai është në ty, ti je plot shpresë. Ai është shpresa dhe të mbush ty me shpresë. Po si kuptohet që ti je plot shpresë?

Cilat janë shenjat?

Shpresa tregohet kur këmbëngul dhe inkurajon.

Krishti që të mbush ty me shpresë të bën ty që të këmbëngulësh, mos të heqësh dorë. Të mos heqësh dorë, çfarë do të thotë nga ana praktike:

- të shkosh të kërkosh edhe për një punë tjetër
- të dorëzosh edhe një CV tjetër
- të provosh edhe një herë, ta japësh dhe një herë atë provimin
- ta lexosh edhe një herë mësimin, ta bësh edhe një përpjekje tjetër
- ta pyesësh edhe një herë

Këmbëngul sepse e di premtimin: kush kërkon, gjen; kush troket, do i hapet; kush lyp, merr. Dhe ti këmbëngul edhe një herë.

Këmbëngulja sjell shpresë dhe shpresa të forcon të këmbëngulësh.

Shiko sa bukur: Është si energji rrethore, ti këmbëngul, mbushesh me shpresë, por ngaqë je plot me shpresë nuk heq dorë, këmbëngul më shumë.

Inkurajim, shpresa na mbush me inkurajim. Le të jenë fjalët tuaja plot shpresë, plot inkurajim, plot jetë. Disa herë aq duhet, një fjalë, një fjalë e mirë, një inkurajim. Dhe duket që je plot shpresë, sepse ti nuk pret të marrësh një fjalë inkurajimi, ti jep inkurajim.

Ilustrim: Po afroreshin diku te 5 mijë shokë në Facebook, dhe fillova duke hequr të gjithë account-et që ishin inaktive dhe account-et dytësore të dyqaneve ose që s'kishin emra realë. I hoqa nja 200. Dhe shikoj një shok që kisha kohë pa folur me të. I shkrova për ta përshëndetur. Ai u gëzua jashtë mase, thjesht pse e përshëndeta, dhe po më tregonte sa rrëmujë e kishte jetën, dhe i thashë: 'A mund të lutem për ty?' Atij sikur i kishe falur botën në atë moment. Aq shumë e ndikoi, thjesht një fjalë e mirë, një përshëndetje, një lutje.

Në fakt, shpesh kaq është. Një inkurajim, një fjalë e mirë, një kompliment, një vlerësim.

Kaq? Disa grimca inkurajimi mund të japin shpresë?

Shumica e njerëzve kaq kanë nevojë. Qeranë e paguajnë vetë, nevojat familjare kujdesen vetë, të gjitha i bëjnë vetë. Shpesh aq u duhet nga ty, një

pjesë nga koha jote.

Perëndia i shpresës të përdor ty për të përcjellë shpresë, për të shpërndarë *grimca shprese*, pasi Krishti banon në ty, ti inkurajon, shpërndan *grimca shprese* dikujt.

Po sikur dikush në familjen tënde të ketë nevojë vetëm për kaq: vetëm për një fjalë të mirë, vetëm për një 'si mund të lutem për ty', 'a të lutem për ty', 'a lutemi tani bashkë'? Një kompliment, një fjalë pozitive? Një grimcë shprese nga ty.

Shpresa prodhon këmbëngulje dhe inkurajim. Perëndia i shpresës që banon në ty, do të veprojë nëpërmjet teje për të shpërndarë grimca shprese. Aq e rëndësishme është.

E di për sa kohë na duhet të inkurajojmë njëri-tjetrin? Inkurajoni njëri-tjetrin ndërsa shikoni ditën që po afrohet. Inkurajoni njëri-tjetrin deri kur të kthehet Krishti.

Një ditë Ai do të kthehet për të marrë bijtë dhe bijat e Tij, dhe shpresa do të jetë perfekte. Derisa kjo ditë të vijë, puna jote është t'i japësh shpresë kësaj bote, shkojmë drejt atyre që janë pa shpresë për t'iu dhënë Shpresën e Krishtit.

Mos është sot dita e parë kur ti do të lejosh Krishtin të banojë në ty? Të mbushesh me shpresë.

Le të lutemi.

Lutja e shpëtimit.